



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 28-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 29. 04. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Lulzim Rrustemi, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic, anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
2. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBFsë

3. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
4. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
5. Basri Hashani, Drejtor i DRKS
6. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
7. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
8. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
9. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
10. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
11. Imer Rustemi, Drejtor i DI
12. Feti Krasniqi, Drejtor i DBZHR
13. Ahmet Maksuti, zyra ligjore
14. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
15. Bekim Krasniqi, "YAHR"
16. Përfaqësues të OJQ "POLIS" (1)
17. Përfaqësuesit e mediave
18. Numër i konsideruar i qytetarëve
19. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
20. Bajram Zaskoku, përkthyes shqip-serbisht
21. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 27 anëtarë nga gjithsej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Në vazhdim tha se rendin e ditës e keni marrë dhe në KPF për shkak të mungesës së materialit është hjek pika e 4-ër dhe në vend të saj kemi plotësimin e rendit të ditës me këtë pikë;

Propozimi i Vendimit për plotësimin e një anëtari në KKSB.

Pastaj pyeti se a ka dikush propozim për plotësimin e rendit të ditës.

Xhevat Olluri, në mbledhjen e kaluar kam propozu plotësimin e rendit të ditës për diskutim lidhur me ndarjen e shkollës profesionale "Adem Gllavica" dhe nuk e di Kryesuese pse atë ditë nuk e pranuat për me shqyrtu këtë pikë dhe me këtë rast keni bërë shkelje të Rregullore së punës së Kuvendit dhe në mënyrë arbitrare nuk e keni pranuar. Në atë mbledhje u vendos që diskutimet për këtë pikë të zhvillohen në mbledhjen e ardhshme në Kuvend e gjithashtu në KPF pas propozimit tim nuk pranuat të hynë në rend dite kjo pikë e që edhe këtu keni bërë shkelje të Rregullores andaj unë edhe sot propozoj që kjo pikë të hynë në rend dite meqë në mbledhjen e kaluar është votu që kjo pikë të hynë në rend dite për diskutim, në të kundërtën unë do të ankohem në MAPL.

Vlora Limani-Hajnuni, unë si Kryesuese e kam shprehur mendimin tim dhe nuk e kam shkelur Rregulloren e punës së Kuvendit dhe e kam vu në votim propozimin e juaj. Gjithashtu në KPF e kam qitë në votim këtë pikë për shqyrtim dhe nuk ka marrë votat dhe konsideroj se nuk kemi shkelje të Rregullores. Akuzat e tilla nuk i pranoj se asnjëherë në mënyrë arbitrare nuk kam vendosë dhe kur t'i jepni propozimet duhet të jenë të qarta. Këtu kemi Drejtorin e arsimit dhe do të na njoftoj për këtë qështje e unë do ta vejë në votim propozimin e juaj.

Xhevat Olluri, po më duhet me dhënë sqarim se unë nuk kam thënë Kuvendi me marr Vendim por kam thënë me diskutu dhe me i rekomandu Kryetarit për fillimin e

procedurave për ndarjen e shkollës së mesme profesionale “Adem Gllavica”. Unë e dita se ke me thënë se a është urgjente apo jo, për këtë vendos Kuvendi por nuk u pyet Kuvendi.

Florent Hoxha, na muajin e kaluar kemi marr Vendim për ta shqyrtuar në Kuvend këtë pikë dhe a na lejon Ligji apo jo këtë do ta thonë delegatët e gjithashtu Drejtori duhet me na njoftu se a është e ligjshme apo jo.

Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për arsim tha se në diskutojmë për arsimin është më se e nevojshme me që në arsim ka mjaft pika që mund të shqyrtohen e gjithashtu ka edhe probleme. Na nuk duhet të bijmë në lajthitje me që arsyeja e ndarjes së shkollës është dhënë gjëja se nuk po mund të fitojmë donaciona. Me ndarjen e kësaj shkolle duhet ta dijmë se lindin shumë probleme dhe se duhet ta dijmë se na nuk jem as Prishtinë e as Ferizaj ku atje shkolat janë të profilizueme. Pastaj tha se gjimnazi ka 1600 nxënës, shkolla villore “Vllëzërit Frashëri” ka 1400 nxënës, ndërsa shkolla e mesme profesionale ka përafërsisht 1200 nxënës, ose shkolla e mesme në Shalë a mundet me ekzistë. Pastaj tha se këqyrni se qfarë pasoja krijohen për ndarjen e shkollës për emërimin e një drejtori dhe shembull kemi ku kemi formu shkollë me 120 nxënës dhe aty duhet një drejtor.

Në vazhdim lexoi Ligjin për themelimin e shkollave që është kompetencë e ministrisë ndërsa Drejtoria e arsimit duhet të parashtroj kërkesë ministrisë.

Lulzim Rrustemi, për këtë pikë në mbledhjen e kaluar kemi votu për shqyrtim me 27 vota është vendos që të shqyrtohet kjo pikë dhe profesori ka propozu plotësisht në përputhshmëri me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Nazmi Krasniqi, e tha edhe Luli se në mbledhjen e kaluar kemi vendos si Kuvend për shqyrtim të kësaj pike. Kjo pikë e ka një arsye meqë edhe suksesi ka rënë në atë shkollë u fol edhe për mungesë të buxhetit se nuk ka buxhet dhe unë nuk pajtohem me këtë meqë nuk po themi që sot me u formu por së paku të përgatitemi për vitin e ardhshëm.

Vlora Limani-Hajnuni, vej në votim propozimin e profesorit se kush është që kjo pikë të hynë për shqyrtim në Kuvend?

Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, 9 apstenime, 2 kundërshtime Kuvendi vendosi që propozimi për shqyrtim për ndarjen e shkollës “Adem Gllavica” të hyn si pikë e 6-te.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozimin e rendit të ditës së bashku me propozimet për ndryshim dhe plotësim të cekura më lartë dhe pas votimit konstatoi se me 29 vota për, Kuvendi aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 27-të e KK-së
2. Raporti tremujor i shpenzimeve të buxhetit, realizimit të investimeve kapitale dhe të hyrat për periudhën Janar-Mars 2016.
3. Propozim Rregullore për plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taxi 15Nr.011-27942 të datës 21. 07. 2014
4. Propozimi i Vendimit për zëvendësimin e anëtarit të KKSB-së
5. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.
6. Propozimi për shqyrtim për ndarjen e shkollës “Adem Gllavica”

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush të thotë diqka?

Florent Hoxha, pyeti se a ka ndonjë kompani të kontraktuar për mirëmbajtjen e parqeve në Lipjan meqë në parkun te shkolla fillore janë hjekë 3-4 ulëse dhe kur do të rregullohen.

Pastaj pyeti se a janë zhvilluar procedurat e prokurimit për lapidarin në Kraishtë se zëdhënsja përmes mjeteve të informimit ka thënë se janë zhvillu procedurat për këtë lapidar.

Lulzim Rrustemi, kohën e fundit nga Kuvendi janë dhënë pronat në shfrytëzim nga 2-3 hektarë dhe gjatë shqyrtimit të këtyre vendimeve ne kemi thënë se këto prona të parcializohën dhe t'u ipen 3-4 bizneseve meqë një biznes apo kompani nuk mund t'i mbuloj 3-4 hektar.

Ramiz Qeriqi, para Kishes në Lipjan një person shet shpez dhe qenë dhe krijohet përshtypja se aty është treg dhe besoj se ai person nuk ka leje për shitje në atë vend andaj kërkoj që inspekcioni të merr masa.

Pastaj tha se herën e kaluar kam thënë që te fabrika e letrës është grumbulluar një material dhe kur përpunohet ai material kundërmon erë të rëndë dhe po shkakton dhimbje koke te lagja që është afër dhe deri me sot nuk kam marrë përgjigje për këtë .

Burbuqe Ilazi , pyeti pse në shtepinë e shëndetit nuk ka aparat për inhalim dhe qytetarët janë të detyruar të shkojnë nëpër ambulanca private apo edhe në Prishtinë ku pjesë e saj kam qenë edhe unë.

Hajrije Salihu, është folë se për aktivitetet profesionale në shkollën profesionale do të ndahen nga 1 mijë euro dhe pyes Drejtorin e arsimit se këto mjete a janë donacion apo ndahen nga mjetet e taksapaguesve.

Merita Zeqiri-Hajrizi, nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport në agjendën për ditën e martirëve është thënë dita e Dëshmorëve dhe martirëve ku ka pasur vërejtje nga qytetarët meqë dihet se dita e Dëshmorëve është me 14 qershor e për këtë gabim kemi dhënë vërejtje edhe në vitin e kaluar dhe e njëjta është përsëritë, andaj kërkoj që në të ardhmen mos të përsëriten këto gabime.

Sefer Tasholli, meqë nuk është Drejtori i prokurimit këtu ju njoftoj se për lapidarin në Kraishtë është shpallë tenderi por ka konkuru vetëm një ofertues dhe ju e dini se me një ofertues nuk mund t'i ipet askujt tenderi dhe tani është shpall tenderi dhe janë të parapara 16 mijë euro për këtë projekt. Për pyetjen e Merites lidhur me datën e Dëshmorëve ka të drejtë mirëpo edhe në atë ditë të martirëve ka të rënë edhe Dëshmorë.

Rasim Hasani, sa i përket pyetjes së Hajrijes lidhur me ndarjen e mjeteve për aktivet e shkollës profesionale unë ju them se në shkollë janë 3-4 projektor apo më shumë që ruhen në paketa dhe mund të shkoni t'i kontrolloni.

Ramiz Qeriqi, kur Nënkrjetari përmendi se ka pasur Dëshmorë edhe në ditën e martirëve unë po them se në agjendë ka qenë gabim që është thënë ditë e Dëshmorëve dhe kërkoj që kjo mos të përsëritet më.

Nazmi Krasniqi, në KPF është kërku që të paraqiten raportet e komiteteve e gjithashtu kërkoj që në KPU të caktohet Lulzim Rrustemi në vend të Ferizit pasi që ky ka dhënë dorheqje, ndërsa Ferizi të caktohet në KSHP në vend Ragip Zejnullahut.

Këtë propozim Kryesuesja e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për miratoi këto:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E KRYESUESIT TË KOMITETIT PËR PLANIFIKIM DHE
URBANIZËM

Neni 1

Me këtë Vendim zëvendësohet Kryesuesi i Komitetit për Planifikim dhe Urbanizëm Feriz Hasani i cili ka dhënë dorëheqje dhe në vend të tij emërohet Lulzim Rustemi anëtar i Kuvendit.

Neni 2.

Mandati i Kryesuesit të Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 3.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 pas rexhistrimit në zyrën e protokolit në MAPL dhe publikimit në Web faqen e Komunës.

Neni 4.

Me Vendim të njoftohet i lartëpërmenduri dhe një kopje të ruhet në materialin e Sektorit për punë të Kuvendit.

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

Neni 1

Me këtë Vendim zëvendësohet anëtari i Komitetit për Shërbime Publike Ragip Zejnullahu i cili ka dhënë dorëheqje për shkak të shkuarjes në detyrë të re dhe në vend të tij emërohet Feriz Hasani anëtar i Kuvendit.

Neni 2

Mandati i anëtarit sipas pikes 1 të këtij Vendimit është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 3

Ky Vendim hynë në fuqi 15 pas rexhistrimit në zyrën protokolit në MAPL dhe publikimit në Web faqen e Komunës.

Neni 4

Me Vendim të njoftohet i lartëpërmenduri dhe një kopje të ruhet në materialin e Sektorit për punë të Kuvendit.

Shtesë: Vendimet.

Meqë pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 27-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 27-të të Kuvendit?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për

Aprovoi
Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 27-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti tremujor i shpenzimeve të buxhetit, realizimit të investimeve kapitale dhe të hyrat për periudhën Janar-Mars 2016.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti. Në fund Drejtori kërkoi nga asambleistët që qdo pyetje ose sygjërim që kanë lidhur me këtë raport ta paraqesin dhe përgjigjjen ose do ta marrin sot ose në mbledhjen e radhës.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, nga materiali që kemi pranuar por edhe nga prezantimi i raportit nga ana e Drejtorit, shihet se buxheti dhe shpenzimet sipas fondeve burimore janë shpenzu me 57.54% çka do të thotë se ka trende pozitive. Investimet kapitale në këtë tabelë shihet se janë 21.92%. Te investimet kapitale në këtë periudhë është vështirë të realizohet, por, tremujori pasues sigurisht dukshëm do të jetë në pozitiv. Në vazhdim tha se kemi edhe shpenzimin e buxhetit sipas kodeve ekonomike nëpër programe për periudhën janar-mars 2016. Për të hyrat vetanake del se kemi një rritje prej 12% në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Taksa për legalizim dhe ajo për ndërtim paraqesin indikatorë të shpenzimit real të buxhetit.

Petrit Kelmendi, kam pyetje për alokimin e buxhetit për shpenzime kapitale. Po ashtu te granti qeveritar e dijmë se në këtë tremujor kemi ngecje në zhvillim të investimeve kapitale. Do të ishte mirë që të kemi një pasqyrë më detale nga prokurimi për vlerën e shpenzuar që është rreth 274.000,00€ sepse për t'u realizuar projektet duhet një procedurë e caktuar e prokurimit.

Blerim Gashi, nga ajo që u tha ne mund t'i japim disa vërejtje dhe sygjërim, posaqërisht po e ceku se trendi i shpenzimeve është pozitiv. Edhe unë po interesohem për shumën 274 mijë euro të cilën e ceku Petriti. Po ashtu kërkoj sqarim për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare mbrenda vendit, pastaj shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse dhe furnizime për zyrë në vlerë prej 13.520,00€ dhe po më duket vlerë bukur e madhe.

Florent Hoxha, shumë nga pyetjet këtu kërkojnë sqarim të detajuar duke u nisur nga planifikimi buxhetor dhe gjendja tash e buxhetit total. Ku prej 12 milion ka dalë në 13 milion e disa dhe kërkoj sqarime kah ka ardhur kjo rritje e buxhetit. Shpenzimi në shërbimet e kontraktuara dhe tjera është bukur i lartë. Vërehet një përqindje e ulët e shpenzimit në disa drejtori të caktuara por ne i inkurajojm ato drejtori që në muajt vijues të ngritin këto shpenzime.

Te shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve nëpër shkolla dhe e dijmë se shkollat nuk kanë automjete prandaj pyes se ku janë shpenzuar ato mjete.

Te shkolla e mesme profesionale kemi mbi 33 mijë euro shpenzime të rrymës edhe për këtë dëshirojmë me dijë si janë bërë ato shpenzime.

Te shkolla e mesme Ulpiana gjithashtu mbi 2 mijë euro për rrymë. Mbi 250 mijë euro pritët që të hy në buxhetin e komunës nga ekspropri i pronave nga niveli qendror.

Te inkasimi i qirave kemi ngecje dhe kërkojmë një kujdes më të madh sepse kemi të bëjmë me një shumë mjaft të madhe të mjeteve.

Lulzim Rrustemi, kemi një prezantim të avansuar të raportit të shpenzimeve gjatë tremujorit të parë. Në vazhdim pyeti Drejtorin lidhur me kategorinë e shpenzimeve për anëtarësim duke pyetur se është e pakjartë për qfarë anëtarësimi e gjithashtu pyeti për shpenzimet për mirëmbajtje të vetuarave dhe shpenzimet e karburanteve ku tha se më duket është një shumë mjaft e lartë e shpenzimeve.

Shkelzen Hajdini, u përgjigj në të gjitha pyetjet dhe sygjerimet e paraqitura nga asambleistët duke arsyetuar raportin më në detale.

Lidhur me pyetjen për shpenzime në 274 mijë euro për investime kapitale sqaroi procedurat e zotimit të mjeteve për investime kapitale.

Në investimet kapitale kemi paguar borxh të trashëguar në shumë prej 46 mijë euro.

Shpenzimi i mjeteve për udhëtime brenda vendit e nënkupton transportin e nxënësve nëpër shkolla dhe nuk bëhet fjalë për shpenzime tjera.

Rritja e buxhetit nga ai i planifikimit në vlerën reale është bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake nga viti i kaluar. E po ashtu rritja e buxhetit mund të ndodh edhe pas përfitimit të ndonjë donacioni.

Shërbimet tjera kontraktuese hyjnë patrimi i Komunës, sigurimi i komunës, shpenzimet gjatë vërshimeve, dëmet materiale pas erërave siqë kanë ndodhë në kulmet e shkollave në Dobrajë dhe Rubovc.

Shpenzimet për mobilje dhe paisje për zyrë nënkupton: letër, tonera, lapsa, kompjutera etj.

Shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve nëpër shkolla nënkupton në mbajejen e autobusëve për transport të nxënësve dhe mekanizmin bujqësorë në shkollën “Adem Gllavica”.

Shpenzimi për anëtarësim kështu quhet kodi dhe këto janë shpenzimet që paguhen për asociacionin e komunave.

Shpenzimet për karburante kemi borxh edhe nga viti i kaluar e mund të ketë edhe faktura më të herëshme nga viti 2012.

Për mirëmbajtjen e automjeteve të komunës kontrata ka përfunduar dhe i kemi përmbush obligimet.

Vlora Buja, te shpenzimet e mirëmbajtjes së kanalizimit janë 20 mijë euro dhe me sa e di unë në këtë vit nuk kemi pas mirëmbajtje të kanalizimit andaj pyes ku janë shpenzu këto mjete.

Shkelzen Hajdini, këto 20 mijë euro nuk janë shpenzu dhe nuk janë në kodin e shpenzimeve për janë planifikim për shpenzim.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalu në shqyrtim të pikës së tretë.

III

Propozim Rregullore për plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taxi 15Nr.011-27942 të datës 21. 07. 2014

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Heset Sahitit, Drejtor i DSHP i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Lulzim Rrustemi, pyeti se a ka kaluar në diskutim publik kjo Rregullore.

Vlora Limani-Hajnuni, jo nuk ka nevojë për diskutim publik meq ndryshohet vetëm një nen.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullores dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi këtë:

RREGULLORE
PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME
AUTOMJETE TAKSI 15NR.011-27942 TË DATËS 21.07.2014

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është plotësimi i Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-27942 të datës 21.07.2014.

2. Neni 9 - Revokimi dhe marrja e Licencës plotësohet si vijon:

Pas paragrafit të 4 shtohet paragrafi i ri paragrafi 5 i cili përkufizohet si vijon:

“ Licenca do ti merret operatorit nëse dy vite radhazi nuk e paguan taksën vjetore për shfrytëzimin e autoparkingut sipas Rregullores për taksa komunale”, ndërsa paragrafi 5 i këtij neni bëhet paragrafi 6 .

Procedurën për revokimin e licencës sipas këtij paragrafi e aplikon sipas detyrës zyrtare Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Rregullorja.

Pas përfundimit të kësaj pike Kryesuesja në ora 12,50 dha pauzë deri në ore 13,50. Pas pauzës në ora 13,50 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katërt.

IV
Propozimi i Vendimit për zëvendësimin e anëtarit të KKSB-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit dhe pastaj hapi shqyrtimin.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar i PDK-se e kemi shqyrtu këtë propozim vendime dhe të njëjtin e përkrahim.

Labinot Shahini, edhe ne e përkrahim këtë propozim vendim.

Ukë Kryeziu, këtu kemi të bëjmë me obligim ligjor dhe e përkrahim këtë vendim.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, asnjë kundër, aprovoi këtë:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI –KKSB-së

Neni 1
Zëvendësimi i anëtarit të KKSB-së

Me këtë Vendim zëvendësohet anëtari i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi z.Sami Bresa në numrin rendor 15 të pikës I të Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 të datës 29.01.2014 ish Kryetar i Këshillit të prindërve dhe në vend të tij caktohet z.**Milazim Sadiku**, Kryetar i sapozgjedhur i Këshillit të prindërve në nivelin komunal .

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSB-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 të datës 29.01.2014.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemajlit, Drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Florent Hoxha, na si grup parlamentar i PDK-se e përkrahim këtë propozim vendim.

Labinot Shahini, edhe ne grupi parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

Hajreije Salihu, gjithashtu edhe na e përkrahim këtë propozim vendim.

Edita Gashi, duke pasur parasysh situatën e rëndë ekonomike që e kemi na e kundërshtojmë këtë vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE SHOQATËS SINDIKALE TE ADMINISTRATËS KOMUNALE

Neni 1

I ipet pëlqimi Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare, në shumë prej 5500 €, (pesë mijë e pesëqind) euro nga kategoria ekonomike subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2016, me qëllim të mbështetjes financiare të 208 (dyqind e tetë) të punësuarve të Administratës Komunale për realizimin e vizitës dy ditore në Republikën e Shqipërisë sipas Kërkesës së Shoqatës Sindikale të pavarur e Administratës Komunale të datës 21.04.2016.

Neni 2

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi

VI

Propozimi për shqyrtim për ndarjen e shkollës “Adem Gllavica”

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, fillimisht i dha fjalën propozuesit të kësaj pike Xhevat Olluri i cili përshëndeti Kryetarin e Komunës e më pastaj tha se iniciativat qëllimëmbira dhe pozitive duhen të përkrahen dhe unë nuk jam kundër askujt. Kjo iniciativë është e kahershme edhe kur kam qenë Drejtor i shkollës por atëherë nuk kanë qenë kushtet për ndarje meqë ka munguar lokali kurse tani janë krijuar kushtet ku gjimnazi së shpejti do të kalojë në objekt të ri. Tani për momentin janë disa trende duke u zhvillu dhe na duhet të përgjigjemi këtyre trendeve meqë Bashkësia Ndërkombëtare është duke u ndihmuar me donacione shkollave profesionale. Në vazhdim tha se pse duhet me u nda shkolla teknike sepse me këtë krijohen profile që i kërkon tregu i punës dhe për këtë Kryetari i Komunës ka obligim me obligu Drejtorin e arsimit që të bënë kërkesë në Ministri për hapjen e këtyre profileve. Në bazë të një projekti Kosova për herë të parë do të përfshihet në hulumtimin e qendrës evropiane për zhvillim të arsimit në Kosovë.

Florent Hoxha, me qenë se na si anëtarë të Kuvendit nuk kemi një material për këtë nismë por në mbledhjen e kaluar Kuvendi ka marrë Vendim për diskutim për ndarjen e shkollës profesionale “Adem Gllavica” në dy shkolla profesionale dhe na si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim që Kryetarin t’i japim një rekomandim që përmes Drejtoratit të arsimit të fillojnë procedurat për ndarjen e kësaj Shkolle.

Blerim Gashi, u arrit që të futet në diskutim kjo pikë dhe duke u bazuar se arsimi në Lipjan nuk është në nivel të mirë atëherë konsideroj se duhet të diskutohet për këtë. Unë apstenoja në fillim për këtë pikë meqë nuk kemi material dhe më duket se është hap i ngutshëm për diskutim dhe gjendja e shkollave nuk është momentalisht e mirë dhe duhet të meremetohen. Pastaj tha se interesimi për drejtime teknike ka rënë e gjithashtu nxënësit më të dobët janë në atë drejtim dhe në bazë të kësaj konsideroj se do të zvogëlohet numri i paraleleve dhe me këtë sigurisht dikush do të mbetet pa punë.

Arben Bahtiri, unë e kam përkrah kërkesën e aleancës por tani shtrohet pyetja se sa kemi kapacitet me e nda shkollën, prandaj propozoj që mos të ngutemi dhe ky propozim të shtyhet për shqyrtim të mëvonshëm. Shkolla profesionale “Adem Gllavica” ka 1200 nxënës dhe na duhet të angazhohemi më shumë për drejtimet bujqësore. Unë nuk jam për me i rekomandu Kryetarin për fillim të procedurave për ndarjen e shkollës së mesme profesionale “Adem Gllavica”.

Hajrije Salihu, unë qëndroj prapa atyre që i tha profesori Xhevat sepse ne i dijmë që shkollat profesionale janë duke fituar donacione kurse te ne nuk janë ndarë donacione për shkak se nuk janë ndarë shkollat. Pastaj tha se shkolla e mesme profesionale “Adem Gllavica” ka 1200 nxënës por kushtet e punës në atë shkollë janë shumë të rënda që vetëm ne që punojmë aty e dijmë se qfarë kushte janë dhe kur fryn era dedyrohemi të gjejmë një nxënës që është mjeshtër për t’i mbyll dritaret . Unë jam që të diskutohet për këtë pikë për ndarjen e kësaj shkolle dhe nëse nuk arrihet për shtator atëherë të ndahet në vitin e ardhshëm. Ne e dijmë se në Shqipëri janë nënshkruar 12 mijë kontratat që pas përfundimit të shkollës profesionale të shkojnë për punë në Gjermani atëherë pse edhe ne mos të ndajmë shkollën.

Nazmi Krasniqi, kjo është vazhdimësi e kërkesës së mëherëshme dhe duhet të inicohet procedura për ndarjen e kësaj shkolle për profesione të caktuara.

Lulzim Rrustemi, ne sot jemi të hendikepuar meqë nuk kemi material për këtë pikë dhe Drejtorja është dashtë të përgatit materialin për këtë mbledhje meqë ka një muaj që është inicu kjo qështje. Profesori Xhevat e arsyetoi mirë qështjen e profesioneve teknike dhe ka hapsirë për këtë. Unë e di që ka probleme financiare por me rishikim të buxhetit mundemi me i parapa mjetet dhe ka mundësi procesi me fillu dhe ne si grup paralemtar i PDK-së e përkrahim këtë iniciativë.

Imri Ahmetit, Kryetar i Komunës, tha se dëgjova shumë gjëra që nganjëherë më habisin thuse se nuk kam jetu këtu ose nuk kemi pasë përgjegjësi në të kaluarën, por përgjegjësinë e kemi të përbashkët prej pas luftës edhe për të mirat edhe për të këqijat edhe për gjendjen që kemi. Për të gjitha këto jemi bashkëpërgjegjës. U tha se duhet t'i përshtatemi tregut dhe pyes se prej kur është tregu qka është urgjente për t'u shqyrtu si pikë e jashtëzakonshme, mos është përgatit dikush për Drejtor dhe a është bërë gati emëri i shkollës mos mendoni se na flejmë dhe nuk i dijmë këto. Kur ishte mbyllja e klasës se 13 ju e dini sa na kanë mbetë pa punë dhe qfarë probleme janë krijue e që edhe në këtë rast që po kërkon kemi me kriju probleme. U tha se me i senzibilizu prindërit për regjistrim në bujqësi. Sot nuk mund ta bindësh askend se po harroni se jemi duke jetu në botën e një shekull të botës virtuale dhe elektronike dhe mos të jetojmë në iluzione për ta marrë bajrakun e dashamirësisë. Nuk është në pyetje ndarja, i ndajmë ndash në 3-4, por është në pyetje përgjegjëshmeria e njerëzve që punojnë dhe faji është te menagjerët se aty ku menagjmenti është i përgjegjshëm edhe gjërat janë në rregull.

Kryetari Olluri po ja them publikisht pse para një jave ke qenë në zyrën time është dashtë të ma thuash këtë dhe pyes se qka është kjo urgjente dhe unë e di mirë se ku po gjuhet guri dhe për proceset që pritet të ndodhin në Lipjan unë nuk ndikohem nga këto kërkesa po u them edhe tjetren se unë nuk do të ndikohem edhe nga rekomandimet për të anashkaluar ligjet pozitive por veprimet e mia qdo herë do të jenë konformë Ligjit. Kjo qështje ka edhe konatocion të natyrave të ndryshme ka edhe impakt financiar meqë aty duhet edhe një Drejtor, një administrator dhe një sekretar dhe pyes pse se keni bërë deri tash. Në nivel të Ministrisë ka marrëveshje me organizatat ndërkombëtare siqë është gizi që nuk e ka marr Lipjanin por komunat tjera dhe këtë e din edhe Petriti dhe duhet ta thotë këtë.

Pastaj pyeti cila është gjendja e Norges, qfarë niveli ka ardhë dhe mos i kanë fajet ndërkombëtarët. Në fund tha se ju mund të merrni rekomandim dhe unë do ta shqyrtoj dhe do të provoj me nxjerr se cili është impakti financiar profesional dhe kadrovik.

Xhevat Olluri, Kryetar unë po habitem dhe njëkohësisht po e kuptoj që paskam bërë ndonjë mëkat që si asambleist e kam bërë një propozim që me bisedu Kuvendi për një qështje. Momentin kur kam propozu e kam dhënë një arsyetim dhe nuk kam propozu që gjithsesi të bëhet kjo dhe kam thënë se është emergjente se së shpejti vjen shtatori. Në KPF i kam thënë Kryesueses që të bisedon me juve për këtë qështje dhe aspak nuk është në interes timin personal apo ndonjë grupi dhe akuzën që propozimi ka prapavi nuk e pranoj dhe nuk mundesh me dhënë argumente Kryetar. Unë nuk e di që ky propozim është politizu kaq shumë dhe mendoj se nuk ka arsye me u politizu.

Meqë propozime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin për nxjerrjen e rekomandimit për Kryetarin për fillimin e procedurave për ndarjen e shkollës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 13 vota për, 14 kundër qka do të thot se u refuzu rekomandimi.

Pasi qështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,⁰⁰